



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 20
Prishtinë, më 15.7.2015, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Slavko Simiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Valdete Bajrami, dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Teuta Haxhiu dhe Etem Arifi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Isa Hasani, zëvendës i Avokatit të Popullit, Bogoljub Staletović, zëvendës i Avokatit të Popullit; Selvetë Gërxhaliu-GDJND; Kaltrina Ahmeti-GLPS dhe Arta Xhylani, praktikante në Kuvendin e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nr. 19;
3. Shqyrtimi i peticionit;
4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e verbër,
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 19.

Kryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 10.7.2015

3. Shqyrtimi i peticionit

Kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit se në mbledhjen e kaluar, nuk kemi mundur të përfundojmë shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga z.Staletoviq, për shkak të mbajtjes së seancës plenare të Kuvendit, dhe tani në këtë mbledhje, e kemi ftuar për të dhënë sqarime në cilësinë e zëvendësit të Avokatit të Popullit, z. Isa Hasani.

Z. Isa Hasani – Përhëndeti anëtarët e Komisionit dhe tha se Avokati i Popullit, në bazë të Ligjit të Avokatit të Popullit, ka nxjerrë një vendim, ku i jepet mundësia për propozim për shkarkim të ndonjë nga zëvendësi. Për marrjen e këtij vendimi, Avokati i Popullit është fokusuar në tri çështje kryesore: përzierja në kompetencat e Avokatit të Popullit nga z. Staletoviq, moskryerja e përgjegjësisë në departamentin e z. Staletoviq dhe çështja e respektimit të orarit të punës.

Nuk është lehtë të merret një vendim i tillë, e sidomos për një zëvendësavokat nga minoritetet, përkatësisht nga komuniteti serb, sepse kanë edhe 4 bashkëpunëtorë të tjerë nga komunitetet, që janë punëtorë shumë të mirë, të cilët e ndihmojnë shumë komunitetin e tyre.

Mytaher Haskuka – U përmenden problemet në aspektin e punës, pra mosparaqitjen e raporteve të punës nga z. Staletoviq. A janë të shënuara apo verifikuara rastet e mosardhjes në punë apo detyrave tjera të tij?

Isa Hasani – Secili nga zëvendësavokatët, ka nga një departament në përgjegjësinë e tij, pastaj vizitat në komuna të Kosovës, gjë që është zvarritur puna nga ana e tij, ndërsa sa i përket mosardhjes në punë, institucioni ia ka dhënë një veturë për dy vite me radhë e që nuk ka pasur mungesë në punë gjatë asaj periudhe, mirëpo me hapjen e dy zyrave rajonale në Ferizaj dhe në Gjakovë, kanë filluar mungesat, sepse prej asaj kohe nuk ka pasur veturë zyrtare. Avokati i Popullit nuk iu jep detyra të shumta zëvendësavokatëve. Pra,

personi në fjalë ka pasur vetëm një rast dhe nuk ka kryer punën e tij, siç është rasti për ujin në Graçanicë.

Salihe Mustafa – U tha që kur ka pasur veturë zyrtare, z. Staletoviq nuk është vonuar në punë, ndërsa në mungesë të saj, ai nuk ka qenë i rregullt. A kanë pasur vetura edhe zëvendësavokatët tjerë, si dhe a kanë evidencë se sa herë ka munguar?

Isa Hasani – Tha se janë 5 zëvendës të Avokatit të Popullit, mirëpo z. Staletoviq ka bërë kërkesën për veturë zyrtare për udhëtimin e tij, edhe pse institucioni ynë ka vetëm 6 vetura. Avokati i Popullit, për shkak të akomodimit më të mirë, ia ka mundësuar përdorimin e veturës për udhëtim, Graçanicë - Prishtinë, përkundër që në kemi qenë në lagje të ndryshme, por jemi pajtuar edhe ne me kërkesën e tij, sepse na ka pyetur edhe neve Avokati i Popullit, por disa kanë kërkuar që të kompensohen për udhëtim, por nuk ka qenë mundësia, ndërsa z. Staletoviq kur iu është marrë vetura, nuk i ka pëlqyer dhe nga ajo kohe është vonuar në punë. Sa i përket evidencës, ai thotë që çdo punëtor ka kartelën elektronike që shënohen hyrjet dhe daljet e tyre, andaj edhe është evidentuar në mënyrë elektronike dhe me kopje fizike.

Kujtim Paçaku – A ka qenë punëtor i rregullt, i zellshëm në punë, përveç çështjes së veturës apo shpenzimeve të udhëtimit, e që duhet paguar, sepse është e çuditshme, pra a meriton ky person të punojë dhe të ketë atë pozitë? Për të primare është të dijë se a ka qenë punëtor i mirë, sepse mosardhja në punë apo çështje tjetër, ekziston zgjidhja, zvogëlim i pagës për mungesë apo si është e paraparë me ligjin e tyre.

Isa Hasani – Ke bërë një pyetje profesionale, por që është në pozitën e njëjtë me z. Staletoviq dhe nuk i përket atij të flasë për punën e një personi me pozitë të njëjtë dhe nuk është kompetencë e tij.

Kryetarja – Tha se për të mos përmendur edhe një herë të gjitha çështjet, sepse i kanë të gjitha materialet, pyeti: kjo ankesë ka kohë që është dërguar, por pasi që Kuvendi nuk ka funksionuar në atë kohë që është pranuar, a ka pasur formë tjetër të procedimit të kësaj lënde?

Isa Hasani – Në bazë të informacioneve që kanë, pala e pakënaqur ka pasur mundësinë e ankesës në këtë Komision, pastaj tjetri institucion është Gjykata Komunale në Prishtinë, si dhe zyrat e organizatave të huaja që janë dhe që kanë ndërlidhje me institucionin e Avokatit të Popullit.

Mexhide Mjaku- Topalli – Deri në shkarkimin e z. Staletoviq, a kanë qenë pagat e barabarta për të gjithë zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe personi në fjalë a ka pasur dalje të shpeshta nga puna?

Isa Hasani – Paga ka qenë e njëjtë për të gjithë zëvendësavokatët, deri në propozimin për shkarkim të z. Staletoviq, ndërsa sa i përket daljeve nga puna, deri në vitin 2013, aq sa ka pas veturën, nuk ka munguar, ndërsa mungesat janë vërejtur pas ndalimit të përdorimit të veturës zyrtare, e daljet në orar të punës, nuk mund të thuhet diçka të

veçantë, sepse zëvendësavokatët kanë takime, tryeza e konferenca, në kuadër të institucionit.

Kryetarja falënderoi Isa Hasanin dhe potencoi që duhet të kemi një qëndrim të drejtë, pa dëmtuar punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, duke shpresuar edhe në punën e avokatit të ri, pa tendencë të veçantë, që për arsye të nacionalitetit të shkaktohen probleme, sepse me ligj i takon që të ketë një zëvendësavokat të këtij komunitet dhe të punohet mënyrë të drejtë e me efikasitet.

Kujtim Paçaku – Kërkoj informacione nga z. Staletoviq lidhur me marrëdhëniet e tij në institucion, me punëtorët e tjerë.

Bogoljub Staletoviq – Falënderoi anëtarët e Komisionit. Ai theksoi se ka qenë i suspenduar në mënyrë të jashtëligjshme. Sipas tij, në fillim institucioni ka funksionuar mirë, duke rezultuar në sjellje të mirë me të dhe punëtorët e tjerë. Ai, po ashtu, theksoi se ka qenë udhëheqës i Departamentit kundër Diskriminimit. Lidhur me ngjarjen, ai tha se në fillim, z. Arsim Agani ka ardhur me shkresë tek ky, në bazë të të cilit ai ka konsideruar se është diskriminuar me faktin se nuk i është vazhduar kontrata e punës. Për këtë rast, ai tha se ka kontaktuar me Avokatin e Popullit, i cili i ka thënë që lidhur me këtë rast, mos të shkruajë shkresa, mirëpo të komunikojnë vetëm gojarisht, gjë që e ka refuzuar z. Staletoviq. Në vazhdim, ai tha se ka më shumë se një vit që i është ndaluar të ushtrojë funksionin e tij, që ka qenë i angazhuar. Ai theksoi se fillimi i këtij rasti ka ndodhur atëherë kur ka kërkuar mbrojtje për drejtorin. Ai tha se vendimi ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë i referohet Ligjit të Avokatit të Popullit, në bazë të të cilit Avokati i Popullit ka të drejtë të paraqesë propozim për shkarkim të zëvendësit të Avokatit të Popullit, mirëpo edhe kjo është e kushtëzuar me plotësimin e disa kriterëve të përcaktuara në ligj. Ai tha se Avokati i Popullit ka arsyetuar këtë me pretendimin se nuk ka qenë i rregullt në punë z. Staletoviq, gjë që sipas tij, kjo nuk është e vërtetë, sepse ky ka qenë i angazhuar në disa seminare ku ka qenë ligjërues me ç’ rast ka munguar dhe për këtë e ka njoftuar Avokatin e Popullit me kohë. Në vazhdim, z. Staletoviq tha se në momentin kur e ka marrë vendimin për suspendim, atij i është ndaluar qasja në objekt dhe përdorimi i mjeteve të punës, me të cilat ai ka punuar deri në momentin kur është suspenduar. Ai, po ashtu, tha se nuk është e drejtë që të zvogëlohen të ardhurat në 50 %, që sipas tij, nuk ka pasur bazë ligjore për këtë. Sipas tij, kjo është e kundërligjshme për faktin se Avokati i Popullit iu ka referuar Ligjit të punës, e jo Ligjit për Avokatin e Popullit, i cili ligj është i veçantë për këtë rast. Në vazhdim, tha se Avokati i Popullit ka bërë dy diskriminime ndaj tij, në rastin e parë kur ia ka ndaluar qasjen në objektin e Avokatit të Popullit, kurse rasti i dytë kur ia ka ndërprerë të ardhurat, pas datës 8 tetor 2014. Ai, po ashtu, tha se edhe suspendimi është i jashtëligjshëm, sepse në bazë të Ligjit të punës, suspendimi nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj, mirëpo suspendimi im ka zgjatur në mënyrë të kundërligjshme. Ai theksoi se kërkon vetëm që të jetë i mbrojtur dhe të punojë si të gjithë të tjerët, në bazë të ligjit. Ai i njoftoi anëtarët e Komisionit se lëndën e ka përcjellë në Komision dhe aty i kanë të gjitha dokumentet që ka pretenduar se i është bërë e padrejtë. Lidhur me suspendimin e tij, tha se i është drejtuar Kuvendit, mirëpo nuk ka marrë përgjigje për shkak të vakumit institucional, që ka mbretëruar vitin e kaluar, pasta iu ka drejtuar edhe

organizatave të huaja, me qëllim të njoftimit të tyre me shkeljet që janë bërë në Institucionin e Avokatin e Popullit. Në vazhdim, e njoftoi Komisionin se ka bërë shumë kërkesa rreth kthimit të tij në institucion, pas skadimit të mandatit, pasi që këtë ia garanton ligji që ai të ushtrojë funksionin e tij, deri në zgjedhjen e zëvendësve të tjerë. Po ashtu, ai theksoi se dëshiron vetëm që të kthehet në punë dhe t'i kthehet 50 % e pagës që i është ndaluar. Z. Staletoviq tha se i ka bërë shkresë edhe Avokatit të ri, z. Hilmi Jasharit, që t'i lejojë qasjen në zyrë, në mënyrë që ai të ketë mundësi të punojë dhe të përgatisë mbrojtjen për të. Lidhur me rastin e z. Agani, ai tha se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë, ka marrë vendim për kthimin e z. Agani në punë dhe këtë vendim nuk e ka zbatuar Avokati i Popullit, me ç' rast ai ka bërë diskriminim, po ashtu edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut ka rekomanduar zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Lidhur me këtë rast, gjatë debateve, tha se Avokati i Popullit i është drejtuar z. Staletoviq, që sa ai të jetë në institucion, z. Agani nuk do të kthehet në punë dhe në momentin kur z. Staletoviq ka kërkuar kthimin në punë të z. Agani, atëherë ai është kthyer kundër z. Staletoviq dhe gjendja ka arritur deri ku është tani.

Valdete Bajrami – Duke u ndërlidhur, tha se nuk mund të quhet diskriminim ndalimi i qasjes në kompjuterin e punës, sepse derisa të merret një vendim lidhur me çështjen e z. Staletoviq, patjetër që duhet të ketë një kontroll mbi punëtorin në fjalë. Ajo, në vazhdim, theksoi se ai është paguar në gjysmën e pagesës, mirëpo vetëm i është ndaluar qasja në kompjuter dhe për këtë arsye, në këtë rast, nuk mund të konsiderohet diskriminim.

Salihe Mustafa – E pyeti z. Staletoviq se si është ndjerë ai që ka qenë i privilegjuar karshi kolegëve të tjerë, të cilët nuk kanë pasur vetura. A janë ndier të diskriminuar kolegët e tij lidhur me këtë rast?

Bogoljub Staletoviq – Lidhur me pyetjen e znj. Valdete Bajrami, tha se ndalimi për qasje në kompjuter është diskriminim dhe ai ka kërkuar nga zyrtari i TI-së që të ketë qasje, mirëpo ai e ka pasur të pamundur, sepse Avokati i Popullit i ka shkruar shkresë atij që të më ndalojë qasjen në kompjuterin e punës. Po ashtu, lidhur me pyetjen tjetër, ai tha se në bazë të rotacionit, ai ka qenë zëvendësi i parë i Avokatit të Popullit, ku ka përfaqësuar Avokatin e Popullit, kur ka qenë jashtë vendit, dhe lidhur me këtë, tha se asnjëherë Avokati i Popullit nuk i ka dhënë kompetencat që i kanë takuar dhe kjo tregon shkelje tjetër, që është jo në rregull. Në momentin kur zëvendësi i parë e zëvendëson Avokatin e Popullit, ai përgjigjet për çdo gjë që vepron, por kjo nuk ka ndodhur, sepse Avokati i Popullit nuk i ka dhënë kompetencat që i është dashur t'i jepen, në kohën kur ky ka qenë zëvendësi i parë. Në vazhdim, tha se edhe me ligj është e përcaktuar se zyrtarët e lartë që jetojnë jashtë Prishtinës, mund t'i shfrytëzojnë makinat zyrtare dhe nuk mund të quhet keqpërdorim shfrytëzimi i makinës zyrtare për ardhje në punë dhe kthim nga puna. Ai tha se veturën zyrtare e ka marrë me marrëveshje me stafin punonjës dhe nuk ka pasur shofer zyrtar, por i është dashur që vetë ta ngasë veturën zyrtare.

Lirije Kajtazi – Tha se anëtarët e Komisionit, me vëmendje e kanë shikuar dokumentacionin e paraqitur nga z. Staletoviq, si dhe nga Avokati i Popullit, dhe me

qëllim që të jenë sa më të saktë, ata kanë kërkuar takim me Avokatin e Popullit dhe me z. Staletoviq, në mënyrë që t'i dëgjojnë deklaratimet e tyre edhe në mënyrë verbale. Në vazhdim, e pyeti z. Staletoviq se a ka bërë ankesë në gjykatë lidhur me këtë çështje.

Bogoljub Staletoviq – Tha se i është drejtuar organizatave të huaja dhe ambasadave, por ata, lidhur me këtë rast, i kanë thënë se presin përgjigje nga Kuvendi. Po ashtu, lidhur me këtë çështje, ai i është drejtuar edhe gjykatës.

Lirije Kajtazi – Lidhur me këtë çështje, kërkoi informacione se a ka marrë përgjigje nga gjyqi.

Bogoljub Staletoviq – Tha se nga gjyqi nuk ka marrë ende përgjigje për shkresën që ia ka drejtuar, mirëpo vetëm ka marrë një njoftim se do të marrë së shpejti përgjigje, pasi që gjyqi ka qenë duke u bartur në Pallatin e Drejtësisë. Ai, në fund, tha se i ka sjellë përgjigjet që janë bërë ndaj shkresës së Avokatit të Popullit, me qëllim të arsyetimit të veprimeve të tij dhe kërkoi që ky material t'iu paraqitet anëtarëve të Komisionit.

Mexhide Mjaku – Topalli – Pyeti z. Staletoviq se a e ka paraqitur raportin e punës së tij që lidhet me fushën e diskriminimit në Raportin vjetor të Avokatit të Popullit, sepse ka pasur vërejtje se z. Staletoviq nuk i ka paraqitur raportet, për të cilat ka qenë i obliguar t'i paraqesë në Raportin vjetor të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit.

Bogoljub Staletoviq – Tha se janë 7 apo 8 pika, në bazë të të cilave, Avokati i Popullit e ka sulmuar dhe ka përgatitur përgjigje, mirëpo i është bllokuar kompjuteri i punës, dhe nëse i lejohet qasja në kompjuter, ai mund t'i paraqesë të gjitha këto të dhëna, të cilat i thekson.

Mexhide Mjaku - Topalli – Duke u ndërlidhur, theksoi se nuk pyeti për këtë çështje, por për raportin e tij për fushën e diskriminimit.

Pas dëgjimit të palëve, anëtarët e Komisionit, pas një debati për këtë çështje, nxorën këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, nuk mund të nxjerrë vendim, përderisa çështja është në shqyrtim gjyqësor dhe nuk mund të konstatojë asgjë, lidhur me këtë çështje, në këtë fazë, derisa gjykata të vendosë për këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi